



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 04, datë 21.02.2020

**Për miratimin e raportit vjetor të
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2019**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 52 pika 1, shkronja “I”, dhe nenit 53 pika 5, shkronja “ë” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 2 të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 29, datë 03.11.2014, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2019, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për paraqitjen e raportit vjetor pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi dhe të Raportit Vjetor në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar